PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE
E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

EMËRTIMI I AKTIVITETIT:

REPART PER PËRPUNIMIN DHE LYERJEN E STRUKTURAVE METALIKE.

VENDODHJA:

QARKU VLORË, BASHKIA VLORË, RRUGA INDUSTRIALE, ZONA INDUSTRIALE SODA.

Sipas shtojces 1 te Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", i ndryshuar: Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve, pika 7.12.i. "Veprimtari të tjera të lyerjes përfshirë ato të metalit". Te gjitha instalimet Leje Mjedisi tipi B.

Kërkues:

Subjekti "RJEPAJ ELEKTROMEKANIKA" SHPK

NIPT: K16828201A

Mars, 2018

TABELA:

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje

1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR 7

2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI..... 8

3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ. 15

4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS. 33

5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS. 37

6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE..... 38

7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS..... 38

8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME. 38

9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS..... 39

10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË). 39

HYRJE

Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, hartohet me kerkese te subjektit "RJEPAJ ELEKTROMEKANIKA" Shpk, me numer NIPT-i: K16828201A, me seli ne Vlore Vlore VLORE Rr.Industriale, Zona Industriale Soda, Vlore dhe me perfaqesues ligjor Z. Arjanit Rjepaj.

Ky subjekt, ka paraqitur kerkesen per hartimin e procedures se konsultimit me publikun prane AKM dhe do te aplikoje prane QKB-AKM per pajisjen me Leje Mjedisore te Tipit B per aktivitetin: Perpunim dhe lyerje te strukturave metalike. Ky aktivitet ndodhet ne Qarkun Vlore, Bashkia Vlore, Rruga Industriale, Zona Industriale Soda. Ky raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, parashikon ndikimet negative dhe pozitive ne mjedis qe mund te shkaktoje aktiviteti, masat qe jane marre e duhet te merren nga subjekti zhvillues me qellim minimizimin e ndotjes dhe zbatimin e kuadrit ligjor mjedisor ne fuqi per vendin tone. Bazuar ne shtojcat I dhe II te Ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", i ndryshuar, ky aktivitet nuk perfshihet ne listen e aktiviteteve te cilat duhet ti nenshtrohen proçedures paraprake ose te thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, si rrjedhoje ky aktivitet mund te aplikoje direkt dhe vetem per pajisjen me leje mjedisore te tipit B sipas Shtojces Nr. 1 te Ligjit Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit", i ndryshuar.

Pamje satelitore e vendodhjes se aktivitetit



Harta topografike e rajonit. Nomeklatura e Hartes ne shkalle 1:2500 (K-34-123-(159-B)



Koordinatat e objektit ne sistemin: Gaus-Kruge		
Nr.	**Koordinatat Lindje Y**	**Koordinatat Veri X**
1	4369214.64	4483204.29
2	4369230.61	4483180.86
3	4369255.32	4483198.64
4	4369239.62	4483221.79

Foto te objektit ku zhvillohet aktiviteti dhe pajisjeve te punes te instaluara

Mjediset rrethuese

Pamje e brendshme e repartit dhe pajisjet e punes

LVD

1. INFORMACION PËR QËLLIMIN E VNM DHE METODIKËN E ZBATUAR

Përshkrimi qëllimit dhe objektivave të VNM

Ky Raport i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis, eshte hartuar bazuar ne legjislacionin mjedisor per VNM dhe ka per qellim qe te parashikoje, identifikoje, vleresoje dhe parandaloje ose minimizoje ndikimin ne mjedis te projektit.

Procedura e vlerësimit të ndikimit në mjedis përfshin:

a) procesin paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis;

b) procesin e thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

Objektivat afatshkurter te VNM jane:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore te projektit te propozuar;
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me efiçence;
- Siguron qe eshte perzgjedhur alternativa me e mire e vendodhjes se projektit.
- Siguron qe jane marre ne konsiderate teknikat me te mira te Disponueshme te teknologjise se propozuar per tu aplikuar.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit te propozuar;
- Mundeson informimin e vendim-marresve, duke gjykuar ne miratimin ose jo te projektit dhe kushteve qe duhet te vendosen ne aktin e miratimit.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimet e pakthyeshme te mjedisit;
- Ndikon ne mbrojtjene burimeve natyrore, peisazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve;
- Permireson aspektet sociale-ekonomike te projektit
- Ndihmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshem te mjedisit.

Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Legjislacioni mjedisor eshte hartuar per te mbrojtur dhe parandaluar ndotjen dhe demtimin e komponenteve te veçante dhe te rendesishem te mjedisit nga faktore te ndryshem, njerezore dhe natyrore.

Nder ligjet me kryesore ne lidhje me kete projekt, mund te permendim:

- **Ligji Nr. 10431 datë 09.06. 2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit".**
- **Ligji Nr. 10440 datë 07.07. 2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis".**
- **Ligj Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per Lejet e Mjedisit".**
- **Ligji Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve".**
- **Ligji Nr.8897 datë 16.05.2002, "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", i ndryshuar.**
- **Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006, "Për mbrojtjen e biodiversitetit".**
- **Vendim Nr. 123, datë 17.2.2011 "Per menaxhimin e zhurmave".**
- **Vendim Nr. 313, dt. 09.05.2012 "Per rregulloren e mbrojtjes se publikut nga shkarkimet ne mjedis".**
- **Vendim Nr. 686, date 29.07.2015 "Per zhvillimin e procedures se VNM-se".**
- **Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore".**

- **Vendim Nr. 177, datë 31.3.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse"**
- **Udhezim Nr. 8, dt.27.11.2007 "Per nivelet kufi te zhurmave".**

Sqarim:
Bazuar ne Ligjin Nr. 10448, date 14.07.2011 "Per lejet e mjedisit", ky aktivitet, perfshihet ne listat e aktiviteteve te cilat duhet te paisen me leje mjedisore te tipit B. (Konkretisht ne piken Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve, pika 7.12.i. "Veprimtari të tjera të lyerjes përfshirë ato të metalit".

2. PËRSHKRIMI I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.

Aktiviteti ne vleresim zhvillohet ne nje magazine e cila eshte ndertuar shume kohe me pare. Reparti i perpunimit dhe lyerjes se strukturave metalike ndodhet ne Zonen Industriale Soda, Rruga Industriale, Bashkia Vlore, Qarku Vlore. Relievi eshte i sheshte. Bimesia e siperfaqeve perreth eshte toka bujqesore te lena djerre, pylli me pisha te buta (pylli i Sodes), si dhe parcelat me ullinj disa dhjetra vjecar ose deri shekullore. Rajoni Jugor ka ndertim gjeologjik dhe reliev me te thjeshte se rajonet e tjera malore te vendit. Ne te nderthuren vargjet malore te perbera nga gelqeroret me luginat e perbera nga terrigjenet. Me kete ndertim gjeologjik lidhen pasurite nentokesore si: nafta, qymyrguri, fosforitet, materialet e ndertimit etj. Zona bën pjesë në brezin të klimës mesdhetare bregdetare. Lugina e Shushices pershkohet nga lumi me te njejtin emer (dege e Vjoses). Ajo eshte e gjere ne pjesen e poshtme, ku ka toka shume te mira bujqesore, dhe mjaft e ngushte e me reliev te ashper, ne pjesen e siperme. Klima eshte tipike mesdhetare, me dimer te bute dhe te lagesht e vere te nxehte dhe te thate. Hidrografia perbehet nga lumi i Vjoses.

Biodiversiteti dhe habitatet

Biodiversiteti

Shqipëria shquhet për një diversitet biologjik e peizazhor të pasur. Në origjinë të këtij diversiteti qëndrojnë pozicioni gjeografik, faktore gjeologjike, pedologjike, hidrologjike, relievi dhe klima. Diversiteti i lartë i ekosistemeve dhe habitateve (ekosisteme detare, bregdetare, laguna e vende të lagëta, delta lumenjsh, duna ranore, liqene, lumenj, shkurreta medhetare, pyje gjethegjere, halore dhe të përzjerë, livadhe e kullota subalpine dhe alpine, ekosisteme të maleve të lartë), ofron një larmi të pasur llojesh bimore të pasur, kryesisht mesdhetare, e cila pasqyrohet më së miri dhe në rrjetin e zonave të mbrojtura të vendit.

Shqipëria me një sipërfaqe prej 28 748 km2, konsiderohet si një prej vendeve me larmi të lartë bimore me rreth 3976 taksa, prej të cilave rreth 110 lloje subendemike dhe rreth 27 taksone endemike, të përfshira në 180 familje, 900 gjini dhe 800 sp. balkanike.

Elementi floristik mesdhetar përbën rreth 24% të llojeve, prej të cilave 8% janë eurimesdhetare, 7% stenomesdhetare, 25% mesdhatre atllantike, 1,5% mesdhetare turaniane, 1,3% mesdhetare orofite, etj. Elementi floristik evropian zë rreth 18 %. Flora e Shqipërisë përmban bimë të terciarit (bime relike). Në këtë numër afro 350 lloje e varietete janë drurë e shkurre pyjore, 85% e të cilëve rriten e zhvillohen spontanisht në natyrë, kurse 15% janë të introduktuar (të sjell nga jashtë), për qëllime ekonomike e dekorative.

Shqipëria konsiderohet rrugë e rëndësishme e migracionit floristik në Ballkan. Rriten 27 lloje endemike bimoresëbashku me subendemizmat numri i tyre arrin në 110 lloje. Midis endemizave shqiptare dallohen paleoendemizmat ku përfshihen llojet me origjinë shumë të vjetër si *Ëlfenia baldaccii, Forsythia europaea, Lunaria telekiana, Crepis bertisce, Petasites doerfleri, Sanguisorba albanica, Leucojum valentinum subsp. vlorense, Aster albanicus subsp. paparistoi, Genista hassertiana, Ajuga piskoi, Genista hassertiana, Astragalus autrani Bald, Cardus cronicus Boiss&Haldr subsp baldaccii* Kozmi., *Hypericum haplophylloides Halesy&Bald,Viola ducagjini Ë.Becker&Kosanin*, etj.

Si rezultat i faktorëve të relievit, klimës, tokës e bimësisë, në vendin tonë dallohen 4 zona fitoklimatike: zona e pyjeve dhe shkurreve mesdhetare, zona e dushkut, zona e ahut dhe e haloreve, dhe zona e kullotave alpine. Në Librin e Kuq përfshihen 405 lloje bimore dhe 575 lloje faunistike sipas statusit të kërcënimit. Tre lloje pyjore kërcënohen se mund të zhduken: gështenja e kalit (*Aesculus hippocastanum*), tisi (*Taxus baccata*) dhe ylli i Alpeve (*Leontopodium alpinum*). Gështenja e kalit dhe Tisi konsiderohen bime relike të terciarit. Bimësia në sistemin e dunave ranore, në grykëderdhjen e lumenjëve, të lagunave e të shkëmbinjëve është e ruajtur në kushtet natyrore, por vihen re dhe shqetësime të saj nga zhvillimi i infrastrukturës, urbanizimit dhe turizmit, të cilët përfaqësojnë kërcënim të përhershëm dhe në rritje. Pyjet natyrore aluvionale të bregdetit përfaqësojnë pyje tipike higrofile të përhapura kryesisht në grykëderdhjet e lumenjve, mbi toka aluvionale kryesisht bazike, me nivel të lartë të ujrave nëntokësore dhe të përmbytura shpesh nga vërshimet apo shirat e rëmbyeshëm. Këta pyje përfaqësohen nga ekosisteme mjaft të larmishme me ndërthurjet me llojet e lianave dhe me elemente bazë ato kozmopolite evropiane higrofile si: verri i zi (*Alnus glutinosa),* frashër i ujit (*Fraxinus angustifolia),* rrënja (*Quercus robur),* plep i bardhë *(Populus alba),* vidhi i vogël *(Ulmus minor),* etj. Në mjediset shkëmbore takohet një shoqërim endemik i *Crithmo-Limonietum anfracti,* prania e fshesës dredhëse (*Limonium anfractum), Dittrichia viscosa, Carpobrotus edulis,* etj. Pjesa më e madhe e pyjeve janë përqëndruar në zonat verilindore e juglindore të vendit. Në llojet fletore sipërfaqen më të madhe e zënë dushqet me 32% të sipërfaqes pyjore; ahu 17%, dhe fletore të tjerë 9%. Nga haloret sipërfaqen më të madhe e ka lloji pishë e zezë me 11% të sipërfaqes

së pyjeve, madje bredhi dhe pishat mesdhetarë. Në florën e Pyjeve mesdhetare përfshihen: pyjet me pishë të egër dhe dushkajat përherëblertë e gjysëmpërherëblertë, kryesisht: *Pinus halepensis Miller, Piunus pinea L., Ulmus minor Miller., Quercus robur L., Fraxinus angustifolius Vohl., Populus alba L., Alnus glutinosa L., Gearte,* etj, shkurret: *Myrtus communis L, Erica lentiscus L., Philyyrea angustifolia, Juniperus oxycedrus L. subsp macrocarpa, Smilex aspera L., Hedera helix L., Clematis flamula L., Periploca graeca L.,* etj.
Flora e Dushkajave të përherëblerta përfaqësohet nga pyjet me ilqe *(Quercus ilex L.), Pistacia lentiscus L., Pistacia terebinthus L., Rosa sempervirens L., Erica arborea L., Cistus incanus L., Arbutus unedo L., Spartium junceum L.,* etj. Flora e dushkajave gjysëm të përherëblerta nga llojet bulger *(Quercus trojane Ëebb.),* valanidhi *(Quercus macrolepis Kotschy),* pyjet me bulger, bungebute *(Quercus pubescens Ëilld.),*, qarr, mëllezë, shkozë, frashër, rrapishtet *(Plantanus orientalis L.),* dellinjë e kuqe (*Junuperus oxycedrus L), Paliurus spinosa Christi-Miller., Coronilla emerus L., Spartium junceum L., Prunus spiniosa L., Colutea arborescens L.,* etj. Flora e zonës së Dushkajave përfshin pyjet e dushkajave gjethërënëse dhe ato të gështenjave, ku takohen pyjet e bungës *(Quercus petraea Mattuska-Liebl),* pyjet e shparthit *(Quercus frainetto Ten),* pyjet me qarr *(Quercus cerris L.)* dhe pyjet e dushkajave të përziera, *Fraxinus ornus L., Carpinus orientalis Miller., Juniperus oxycederus L., Lembotropis nigricans Greati., Crataegus ssp.,* etj. Flora e zonës së Ahut pëmban pyjet me pishë të zezë *(Pinus nigra Arnold),* me ah *(Fagus sylvatica L),* me bredh (*Abies alba Miller),* me rrobull *(Pinus leucodermis Antoine), Pinus mugo, Pinus peuce, Acer pseudoplantanus L., Sorbus aucuparia L., Populus tremula L., Quercus pubescens Ëilld., Carpinus orientalis Miller* etj. Flora shkurrore është e pasur dhe takohen: *Carpinus betulus L., Juniperus communis, Cornus sanguinea, Daphne oleoides Schr., Daphne laureola L., Daphne blagayana Freyer., Astragalus creticus Lam., Daphne mezereum L., Corylus avellana L., Corylus colurna L.,Salix amplexicaulis Bory.,* etj. *Vaccinnium myrtillus, Forsythia europaea Deg et Bald., Genista hassertiana K.Richer., Minuartia baldaccii Nattf., Narthecium scardicum, Siderites raheseri Bas et Malder., Saxifraga grisabachii Degen et Dorfler.,Rubus idaeus L.,* etj.
Interesante është flora që rriten në luginat e gropat akullnajore, në rëpirat karbonatike etj, ku takohen bimë endemike e subendemike apo dhe ballkanike si: *Ligusticum albanicum Jav., Lilium albanicum Griseb., Lunaria telekiana Jav., Cistus albanicum E.F.Earburg.,* etj.
Fauna përfaqësohet kryesisht nga elementi evroaziatik, por edhe nga elementet holarktik, mesdhetar si dhe endemizmat e subendemizmat ballkanike. Shqipëria përbën gjithashtu një biokoridorr të lëvizjeve faunistike nga veriu në jug të Evropës e më tej në Afrikën verirore e Azinë e Vogël dhe e ndërsjellta. Në ujrat e detit Adriatik, të Jonit dhe ato të brendshme gjendet një faunë e pasusr parruazoresh dhe rruazoresh, që nga celenteratet e deri te gjitarët e lartë. Nga parruazoret takohen rreth 46 lloje ekinodermatesh, 115 lloje krustace dhe 520 lloje molusqesh bivalvore dhe gasteropode të ujrave detare, të ëmbëla dhe tokësore, nga 720 të pritshëm. Numerohen afro 4000 lloje insektesh, nga 40000 lloje të pritshëm. Grupin më të madh e përbënë rendi i Lepidoptera me rreth 1700 lloje, rendi i flatramembranorëve me 850 lloje, të flatrafortëve 600 lloje dhe gjysemflatrafortëve 320 lloje. Fluturat përfshijnë rreth 142 lloje të lidhura me pyllin, të shpërndarë në 20 familje. Rreth 50 prej tyre njihen si dëmtues të pyjeve. Afro 10 prej tyre shpesh japin shpërthime të shumëzimit masiv; ndër to më shumë dëme shkatojnë: procesionaria e pishës *(Thaumetopoea pityocampa*), gjethpërdredhësi i dushkut *(Lymantria dispar),* etj. Flutura "special taxa" janë 104 lloje, një pjesë e të cilave të rrezikuara. Nga Fluturat takohet një lloj subendemik *Pseudochazara cingovskii.* Iktiofauna përfshin 313 lloje e nënlloje, nga 350 lloje të pritshëm. Ujrave të ëmbla i përkasin 64 lloje, të ujrave detare 249 lloje dhe 4

lloje janë endemike. Amfibët dhe rrëshqanorët përfaqësojnë një herpetofaunë të pasur me 15 lloje amfibësh, nga 16 të pritshëm dhe 36 lloje rrëshqanorësh, nga 38 të pritshëm. Në pyje jetojnë një numër i konsiderueshëm amfibësh afro 10-12 lloje dhe 8-10 lloje rrëshqanorësh. Nga Amfibet lloji *Rana epeirotica* është lloj subendemik.
Shpendët përbëhen nga 323 lloje, nga 335 lloje të pritshëm. Përfaqësohen në 19 rende dhe 54 familje. Rreth 118 lloje shpendësh janë të përhershëm ose 46% e ornitofaunës, 72 lloje janë veronjës, 45 lloje janë dimëronjës, 22 lloje janë kalimtarë, 26 lloje janë rastesor dhe 22 lloje citohen nga literature. Nga shpendët rreth 62 lloje janë të lidhura tërësisht me jetën e pyllit, nga këta 42 lloje janë të përhershëm, 16 lloje veronjës, 2 lloje dimëronjës dhe 2 lloje kalimtar. Përsa i përket shpendëve, në zonat pyjore të larta gjenden 60 specie që jetojnë në pyll ose janë të lidhura me pyllin. Nga gjithë llojet e shpendëve 43 lloje janë të rrallë e që kërkojnë mbrojtje të veçantë. Në listën e shpendëve të përfshirë në Librin e Kuq është Pelikani kacurrel, Shqiponja e rosave, Skifterët e ndryshëm, pra shpendët grabitqarë të rendit Falconiformës, të familjes së Ardeideve (Cafkat) etj. Gjitarët përfaqësohen me 70 lloje, të pritshëm 84 lloje, afro 42% të mammalofaunës evropiane (200 lloje). Nga gjitarët 64 janë tokësorë dhe 5 detar. Rend i Lakuriqëve të natës *(Chiroptera)* ka 26 lloje. Rendi i bretësve *(Rodentia)* me 23 lloje. Rend i mishngrënësve *(Carnivoral)* me 13 lloje. Rendi Insektngrënësit *(Insectivora)* me 11 lloje. Nga 84 lloje të pritshëm të gjitarëve, afro 60 prej tyre janë të lidhur me jetën e pyllit, veçanërisht për 13 lloje gjitarësh, jeta e të cilëve është e lidhur tepër ngushtë me ekosistemin pyjor. I rëndësishëm paraqitet pylli edhe për 24 lloje të tjerë gjitarësh, të cilët konsiderohen banorë të tij, por që takohen edhe në habitate e mjedise të tjerë jashtë pyllit. Pylli është i rëndësishëm dhe për 23 lloje të tjerë gjitarësh të konsideruar si lloje shoqërues. Gjitarët e mëdhenj "special taxa" me rëndësi të veçantë janë ariu *(Ursus arctos)*, rriqebulli *(Lynx lynx)*, ujku *(Canis lupus)*, dhija e egër *(Rupicapra rupicapra)*, dhe kaprolli *(Capreolus capreolus)*. Lepuri i gropës *(Oryctolagus cuniculus)* jeton vetëm në ishullin e Sazanit. Nga gjitarët 3 lloje janë cilësuar subendemike, *Pitymys thomasi, Pitymys felteni* dhe *Talpa stankovici.* Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdhenj në brendësi të vendit përfaqësojnë zona të rëndësishme, veçanërisht për dimërimin e shpendëve migratorë, mesatarisht rreth 70 lloje shpendësh uji me një numër prej 180,000 individë, që kalojnë dimrin në to. Shqipëria është një pikë e rëndësishme e kryqëzimit të rrugëve migratore të shpendëve, lakuriqëve të natës dhe insekteve.

LARMIA BIOLOGJIKE E VENDIT TONË

Kategoritë taksonomike	Numri i llojeve në Shqipëri	Nr. i llojeve në Evropë
Alga	210	ca.2500
Algae mikroskopike (diatome)	1300	16.000
Kërpudha	800	
Likene	400	1200
Myshqe	530	10.000
Ferna	51	145
Bimë me Lule	976	13415
Molusqe	Të panjohura	834
Insekte	40.000	4600 (14.000)
Decapode	115	150 (Adriatik)
Ekinodermate	94	46
Peshq	313 (350)	618 (Medsdheu)
Peshq detare	249	Të panjohura

Peshq të ujrave të ëmbla	**64**	**Të panjohura**
Amfibë	**15 (16)**	**62**
Reptilë	**36 (38)**	**123**
Shpendë	**323 (335)**	**514**
Gjitarë	**70 (84)**	**200**

Lloje me rëndësi ruajtjeje për Evropën

Lloje të mbrojtura nga Konventa e Bernës (T-PVS (2002): 22-lloje bimore (17 bimë të larta dhe 4-alga dhe një lloj myshku.

Lloje të mbrojtura nga Direktiva e Habitateve (92/43/EEC): 16-lloje bimore (14 bimë të larta, dhe 2-lloje myshqesh.

Rreth 80 % e tyre janë jashtë Rrjetit të ZM në vendin tonë.

Vetëm 2-lloje bimore: *Galanthus reginae-olgae* (VU B2ab (iii,v) dhe *Solenanthus albanicus* (EN B1ab(v)+2ab(v). Janë të mbrojtura ndërkombëtarisht dhe vlerësohen si të rrezikuara nga IUCN. 5-lloje të tjera janë propozuar për t'u përfshirë në kategorinë e Rrezikuar.

Së paku 72 kurrizore dhe 18 lloje invertebrore me rëndësi globale. Për disa prej tyre (*Pelicanus crispus, Phalacrocorax pygmeus, Salmo letnica* dhe *Acipenser sturio*), janë të rrezikuara sipas IUCN-së.

Lloje bimore me rëndësi ruajtjeje Globale

Lloje bimore me rëndësi ruajtjeje Globale

Scientific name	IUCN	Statusi
1.*Aesculus hippocastanum* L.	NT	Pranuar
2.*Galanthus reginae-olgae* Orph.& Pridgeon	VU B2ab(iii,v)	Pranuar
3.*Caldesia parnassiifolia* (L.) Parl.	LC	Pranuar
4. *Carex markgrafii* Kük.	VU D2	Propozuar
5.*Colchicum macedonicum* Košanin	EN C1 C2(a i)	Propozuar
6.*Festuca galicicae* Horvat ex Markgr.-Dann	EN B1+B2ab(iii)	Propozuar
7.*Ophrys bertolonii* Moretti	LC	Pranuar
8.*Ophrys insectifera* L.	LC	Pranuar
9.*Marsilea quadrifolia* L.	LC	Pranuar
10.*Ramonda serbica* Pancic	LC	Pranuar
11.*Salvinia natans* (L.) All.	LC	Pranuar
12.*Stipa mayeri* Martinovský	EN B2ab(iii)	Propozuar
13.*Tulipa albanica* Kit Tan & Shuka	CR B2ac(i,iv)	Propozuar
14.*Festucopsis serpentini* (C.E. Hubb) Melderis	LC	Propozuar
15.*Crocus scardicus* Košanin	LC	Propozuar
16.*Scilla albanica* Turrill.	NT	Propozuar
17.*Solenanthus albanicus* Degen & Baldacci	EN B1ab(v)+2ab(v)	Pranuar

Informacion rreth bimesise dhe zonave te mbrojtura te rajonit.

Në Shqipëri, zonat e mbrojtura sidomos 10 vjeçarin e fundit, janë kthyer në një objekt të rëndësishëm pune të disa institucioneve të vendit, të cilat kanë synuar në evidentimin, ruajtjen, mirëmenaxhimin e përdorimin në mënyrë të qëndrueshme të tyre.

Aktualisht në Shqipëri zonat e mbrojtura përbëjnë rreth 10% të territorit. Ndonëse shpallja e tyre është bërë gradualisht ndër vite, duke filluar që në vitin 1940, deri në vitin 2002 ka munguar nje ligj mbi te cilin të mbeshtetet kategorizimi, ruajtja e menaxhimi i këtyre zonave. Me daljen e këtij ligji në qershor të 2002 duhet thënë se ka filluar një koncept i ri që përshtatet me atë bashkëkohor dhe që në tre vitet e fundit ka gjetur zbatim në rritjen me dyfish të territorit të vendit. Rrjeti i zonave të mbrojtura mbështetet në kategoritë menaxhuese të Qëndrës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Themelet e zonave të mbrojtura janë hedhur që në vitin 1940 me shpalljen/krijimin e Rezervatit të Parë Shtetëror të Gjuetisë (Kune- Vain-Tale) në Lezhë dhe në Parkun Kombëtar "Mali i Tomorrit" në Berat. Në vitin 1956, në mbështetje të Dekretit "Mbi gjuetinë dhe peshkimin në ujërat malorë" u krijua rezervati i gjuetisë në Rrushkull. Në vitin 1960, zyrtarisht krijohet Parku Kombetar "Mali i Dajtit" dhe 6 vjet më vonë numri i tyre rritet në 6 (Thethi, Lura, Llogaraja, Dajti dhe Drenova). Parqe Kombëtare u shpallën zona me vlera të rralla e të veçanta natyrore, shkencore, shoqërore e rekreative, ku ruheshin të pa prekur ekosistemet natyrore dhe shërbenin për ruajtjen e florës dhe faunës së egër. Deri në vitin 1970 numri i rezervateve të gjuetisë arriti në 15 zona pyjore e lagunore. Me dekretin e vitit 1977 u bë riklasifikimi i rezervateve të gjuetisë dhe numri i tyre arriti në 25. Në vitin 1981 për herë të parë u vunë në mbrojtje shtetërore pasuritë natyrore të rralla, duke shpallur Monumente Natyre drurët e grumbuj pyjorë me vlerë shkencore, biologjike, historike e didaktike.

Ne rajonin e Vlores, zona e mbrojtur me e afert me projektin ne vleresim eshte "Laguna e Nartes". Zona e mbrojtur ndodhet ne nje distance te konsiderueshme rreth 3.3km ne veri te objektit ne vleresim.

Objekti ne vleresim nuk ben pjese ne zonen e mbrojtur "Vjose-Narte".

Pershkrimi i zones se mbrojtur (Peizazhi i Mbrojtur "Vjose-Narte"(Kategoria V))

Peizazhi ujor/tokësor i mbrojtur ka një sipërfaqe të përgjithshme orej 19 738 ha, të përbërë nga:

Sipërfaqe ligatinore (sipërfaqe ujore, zona të lagëta, ranore/toka margjinale)	7225 ha;
Sipërfaqe pyjore	1167 ha;
Sipërfaqe bujqësore	7798 ha;
Sipërfaqe urbane	277 ha;
Sipërfaqe ujore	2985 ha;
Aeroporti	286 ha.

Peizazhi ujor/tokësor i mbrojtur ka këto ndarje zonale:

a) Zona qendrore e ruajtjes së biodiversitetit (shënuar në hartë me shkronjën "A") përfshin rezervatin e Pishë-Poros, lagunat e Kallenges, pyllin e Poros, Shamadurën, Limopuan, pyllin dhe ishujt e Zvërnecit. Brenda saj ka dy nënndarje (A1 dhe A2), që përcaktojnë mënyrën e administrimit. Zonat e nënndarjes A1 ruhen dhe mbrohen në mënyrë strikte. Zonat e nën-ndarjes A2 ruhen, por edhe përdoren për qëllime ripërtëritje natyrore.

b) Zonat e përdorimit tradicional (shënuar në hartë me shkronjën "B"), që nuk cenojnë brojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, përfshijnë tokat bujqësore (të Dellinjës, Zhukës dhe të aeroportit), kriporet dhe pjesën perëndimore të lagunës së Nartës. Brenda saj ka dy nënndarje (B1 dhe B2), për mënyrën e administrimit.
Në nënndarjen B1 zhvillohen veprimtari ekonomike tradicionale, si peshkimi, akuakultura, gjuetia, turizmi, bujqësia dhe blegtoria. Në nënndarjen B2 zhvillohet veprimtaria ekonomike tradicionale e nxjerrjes së kripës.
c) Zona e zhvillimit të qëndrueshëm (shënuar në hartë me shkronjën "C") përmbledh fushën e Bilbilit, të Akernisë, Novoselës, Skrofotinës, Panajasë dhe Nartës, si dhe kodrat e fshatrave Trevllazër, Llakatund, Kërkovë e Bestrovë. Në brendësi të kësaj zone mund të zhvillohen veprimtari ekonomike, si bujqësi, gjueti, blegtori, tregti, pemëtari, ndërtime etj., që nuk cenojnë natyrën dhe biodiversitetin.
ç) Zona e zhvillimit turistik (shënuar në hartë me shkronjën "D").

Harta e zones se mbrojtur te Lagunes se Nartes



3. INFORMACION PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ.

Ne zonen e zbatimit te ketij projekti nuk ka burime ujore te rendesishme te identifikuara. Burimet ujore te kesaj zone dhe me i madhi i kesaj zone eshte "Deti Adriatik", qe ndodhet rreth 500m larg objektit ne perendim, si dhe Laguna Nartes rreth 3.3km ne veri te objektit.

Pamje satelitore e pozicionimit te burimeve ujore ne rajon

Përshkrimi i zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti përfshire edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

Në Shqipëri, Zonat e Mbrojtura janë të konsideruara si pjesë/sipërfaqe e tokës dhe/ose ujit, detare/bregdetare, të destinuara kryesisht për konservimin e biodiversitetit, burimet natyrore dhe kulturore që shoqërojnë atë/ato dhe që janë të menaxhuara në mënyrë të ligjshme dhe/ose në mënyra të tjera efektive. Rrjeti i zonave të mbrojtura është bazuar në kategoritë e menaxhimit të IUCN dhe sistemi i ndërtuar për këtë qëllim është në përputhje me sistemin ndërkombëtar IUCN. Të gjashtë kategoritë e sistemit janë ekuivalente, të barabarta dhe të rëndësishme dhe ato përfshijnë të gjitha nivelet e ndërhyrjes njerëzore, të pranueshme për kategorinë respektive. Krijimi i Zonave të Mbrojtura ka filluar që në vitin 1940. Në 1981, për herë të parë, asete të rralla natyrore u vendosën në mbrojtjen shtetërore duke shpallur si Monumente të Natyrës pyjet me vlerë shkencore, biologjike, historike dhe didaktike. Zona ne vlerësim nuk vlerësohet si zone me status te veçante nga MM. Sic shihet edhe ne harten e meposhteme, zona ne vleresim permban zonat e mbrojtura si meposhte:

Zonat e mbrojtura në Republikën e Shqipërisë (Sipas faqes zyrtare të MM)



RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA NË SHQIPËRI

MINISTRIA E MJEDISIT — **VITI 2014-MARS**

Nr.	Kategoria	Qarku	Rrethi	Emëri i ZM	Miratimi	Nr.ZM	Sipërf. Ha
1	I	Kukës	Tropojë	Lumi i Gashit	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	3,000.0
2	I	Gjirokastër	Gjirokastër	Kardhiq	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	1,800.0
	KATEGORIA I	Rezervat Strikt Natyror/Rezervat Shkencor - Kategoria I (RSN)			SHUMA I	2	4,800.0
3		Shkodër	Shkoder	Thethi	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	2,630.0
4	II	Dibër	Dibër	Lura	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,280.0
5	II	Vlorë	Vlorë	Llogara	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,010.0
6	II	Korçë	Korçë	Bredhi i Drenovës	VKM nr. 96, datë 21.11.1966	1	1,380.0
8	II	Kukës	Tropojë	Lugina e Valbonës	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	8,000.0
9	II	Durrës	Kruje	Qafë Shtamë	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	2,000.0
10	II	Dibër	Mat	Zall Gjocaj	VKM nr.102, datë 15.01.1996	1	140.0
11	II	Korçë	Korçë	Prespa	VKM nr. 80, datë 18.02.1999	1	27,750.0
12	II	Vlorë	Sarandë	Butrinti	VKM nr.134, datë 20.02.2013	1	9,424.4
13	II	Tiranë,Durres		Mali i Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006	1	29,216.9
		Tirane	Tirane	Mali I Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		26,772.7
		Durres	Kruje	Mali I Dajtit	VKM nr.402, datë 21.06.2006		2,444.2
14	II	Fier, Tiranë		Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007	1	22,230.2
		Fier	Lushnjë	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		19,411.1
		Fier	Fier	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		2,074.5
		Tirane	Kavaje	Divjakë-Karavasta	VKM nr.687, datë 19.10.2007		744.6
15	II	Elbasan, Diber		Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008	1	33,927.7
		Elbasan	Librazhd	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		33,760.1
		Diber, Kukes	Bulqize	Shebenik-Jabllanice	VKM nr.640, datë 21.05.2008		167.6
16	II	Gjirokastër, Korce		Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631,datë 17.12.2008	1	34,361.1
		Permet	Permet	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631,datë 17.12.2008		33,165.3
		Korce	Kolonje	Bredhi i Hotovës-Dangelli	VKM nr.1631,datë 17.12.2008		1,195.8
17	II	Vlore	Vlore	Karaburun-Sazan	VKM nr.289, date 28.04.2010	1	12,428.0
	II	Berat, Elbasan		Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012	1	24,723.1
18	II	Berat	Berat	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		8,398.4
		Berat	Skrapar	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		15,045.8
		Elbasan	Gramsh	Mali i Tomorrit	VKM nr.432, datë 18.07.2012		1,278.9
	KATEGORIA II	Park Kombetar - Kategoria II (PK)			SHUMA II	15	210,501.4
19	III	Shqipëri	Shqipëri	BioMonumente Nr.	VKM nr.676,datë 20.12.2002	348	0.0
20	III			GjeoMonumente Nr.	VKM nr.676,datë 20.12.2002	398	0.0
	III			ShumaBio&Gjeo Nr.		746	0.0
21	III	Gjirokastër	Gjirokastër	Bredhi i Sotrës	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	1,740.0
22		Gjirokastër	Gjirokastër	Zhej	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	1,500.0
23	III	Vlorë	Delvinë	Syri i Kaltër	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	180.0
24	III	Dibër	Dibër	Vlashaj	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	50.0
				Shuma MonNatyre Nr.		4	0.0
				Totali MonNatyre Nr	VKM nr.676,datë 20.12.2002	750	0.0
	KATEGORIA III	Monument Natyre - Kategoria III (MN)			SHUMA III		3,470.0
25	IV	Vlorë	Vlorë	Karaburun	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	20,000.0
26	IV	Korçë	Devoll	Cangonj	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
27	IV	Berat	Skrapar	Bogovë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
28	IV	Korçë	Korçë	Krastafillak	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	250.0
29	IV	Elbasan	Librazhd	Kuturman	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	3,600.0
30	IV	Fier	Fier	Pishë Poro	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	1,500.0
31	IV	Lezhë	Lezhë	Berzanë	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	880.0
32	IV	Fier	Fier	Levan	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	200.0
33	IV	Berat	Berat	Balloll	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	330.0
34	IV	Elbasan	Elbasan	Qafë Bushi	Rreg.MB nr.1, datë 27.7.1977	1	500.0
35	IV	Durrës	Durrës	Rrushkull	Urdhër MB nr.2,datë 26.12.1995	1	650.0
36	IV	Vlorë	Delvinë	Rrëzomë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	1,400.0
37	IV	Kukës	Has	Tej Drini Bardhë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	30.0
38	IV	Korçë	Kolonjë	Gërmenj-Shelegur	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	430.0
39	IV	Elbasan	Librazhd	Polis	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	45.0
40	IV	Elbasan	Librazhd	Stravaj	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	400.0
41	IV	Elbasan	Librazhd	Sopot	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	300.0
42	IV	Elbasan	Librazhd	Dardhë-Xhyrë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	400.0
43	IV	Shkodër	Shkodër	Liqeni i Shkodrës	VKM nr. 684,datë 02.11.2005	1	26,535.0
44	IV	Lezhë	Lezhë	Kune-Vain-Tale	VKM nr.432, datë 28.04.2010	1	4,393.2
45	IV	Lezhë	Kurbin	Patok-Fushëkuqe-Ishem	VKM nr.995, datë 03.11.2010	1	5,000.7
46	IV	Diber, Kukes		Korab-Koritnik	VKM nr.898,datë 21.12.2011	1	55,550.2
		Diber	Diber	Korab-Koritnik	VKM nr.898,datë 21.12.2011		20,663.4
		Kukës	Kukes	Korab-Koritnik	VKM nr.898,datë 21.12.2011		34,886.8
	IV/1	Park Natyror Rajonal					
47	IV/1	Diber	Mat	Liqeni i Ulzez dhe zona perreth tij	VKQ nr. 16, date 03.04.2013	1	4,206.0
	KATEGORIA IV	Rezervat Natyror I Menaxhuar/Park Natyror - Kategoria IV (RNM)			SHUMA IV	23	127,180.1
48	V	Korçë	Devoll	Nikolicë	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	510.0
49	V	Korçë	Pogradec	Pogradec	VKM nr. 80,datë 18.02.1999	1	27,323.0
50	V	Vlorë	Vlorë	Vjosë-Nartë	VKM nr.680,datë 22.10.2004	1	19,738.0
51	V	Shkodër	Shkodër	Lumi Buna-Velipojë	VKM nr.682,datë 02.11.2005	1	23,027.0

52	V	Tiranë,Diber,Elbasan		M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007	1	25,266.4
		Tirane	Tirane	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		13,213.6
		Diber	Mat	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		3,016.7
		Diber	Bulqize	M.Gropa-Bizë-Martanesh	VKM nr.49, datë 31.01.2007		9,036.1
	KATEGORIA V	Peizazh I Mbrojtur - Kategoria V (PM)			SHUMA V	5	95,864.4
53	VI	Dibër	Dibër	Luzni-Bulaç	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	5,900.0
54	VI	Korçë	Kolonjë	Piskal-Shqeri	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	5,400.0
55	VI	Lezhë	Mirditë	Bjeshka e Oroshit	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	4,745.0
56	VI	Korçë	Pogradec	Guri i Nikës	VKM nr.102,datë 15.01.1996	1	2,200.0
	KATEGORIA VI	Zone e Mbrojtur e Burimeve te Natyrore te Menaxhuara - Kategoria VI (ZMBNM)			SHUMA VI	4	18,245.0
	TOTALI I ZM				16%	799	460,060.9

	Sip. Republikës	2,874,800.00		ZM pa Sip.Detare	16.54%		446,799.7
				Sip. Detare, Ha	0.5%		13,261.2
					Karaburun-Sazan		12,428.0
					Butrint		833.2
				Sip. Bregdetare dhe Detare	%/Totalit ZM	25.95%	119,401.5

Shkurtesat:

a	VKM	Vendim i Keshillit te Ministrave
b	VKQ	Vendim i Keshillit te Qarkut
c	MB	Ministria e Bujqesise
d	ZM	Zone e Mbrojtur

LISTA E ZONAVE RAMSAR

1	RAMSAR	Fier	Lushnje, Fier	Laguna Karavastase_Pisha Divjakes	VKM nr.413,datë 22.08.1994	Nr.Site 781, dt.29.11.1995	20,000.0
2	RAMSAR	Vlore	Sarande	Kanali Çukes-Butrint-Kepi Stilos	VKM nr.531, datë 31.10.2002	Nr.Site 1290, dt.28.3.2003	13,500.0
3	RAMSAR	Shkoder	Shkoder	Liqeni Shkodres-Lumi Bunes	VKM nr.683, datë 02.11.2005	Nr.Site 1598, dt.2.2.2006	49,562.0
4	RAMSAR	Korce	Korce,Devoll	Liqeni i Prespave	VKM nr. 489, dt. 13.06.2013	Nr.Site 2151, dt 03.07.2013	15,118.6
	TOTALI				%/Totali Republikës	3.42%	98,180.6

DREJTORIA E BIODIVERSITETIT DHE ZONAT E MBROJTURA
SEKTORI I ZONAVE TË MBROJTURA
Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Tiranë.
www.mjedisi.gov.al/

Monumentet Natyrore te Rrethit Vlore.(Sipas VKM 676)

Nr.	Monumenti Natyror	Nr.	Monumenti Natyror
1	Qiparisi i Kambanores se Kishes se Vunoit	27	Shpella e Pirateve (Dhermi)
2	Lisat e Pilurit	28	Shpella e Odisese (Surianit)
3	Rrapi i Kosmarit Kudhes	29	Shpella e Duk Gjonit
4	Rrapi i Palases	30	Kanioni i Gjipese
5	Rrapi i Shkolles nr.1	31	Bokerimat e Vunoit
6	Rrapi i Xhamise	32	Rrethi i Plakes (Brataj)
7	Rrapi i Çesmes (Mifol)	33	Ujevara e Ramices
8	Ilqet i Zarelit me (0,5 ha)	34	Dunat e Nartes
9	Rrapi i Kroit te Madh	35	Delta e Perroit te Palases
10	Rrapi Laze	36	Burim i kripur i Bashajt
11	Mbihipja e Çikes	37	Vali i Vranishtit (burim i madh)
12	Mbihipja aktive e Dukatit	38	Laguna Limopuo
13	Shkeputje e re aktive e Llogarase	39	Rrepet e Buronjave Kuç
14	Tarraca detare e Kusbabait	40	Pisha Flamur- Llogara
15	Tarraca detare e ishshtepise pushimit punetorve	41	Rrapi Mesaplikut
16	Gjiri dhe shpellat e Grames	42	Karthi i Terbaçit
17	Bariera Koralore e grykes se Diallit	43	Rrapi i Dukatit
18	Falezat e Sazanit	44	Rrepet e Izvorit
19	Shpella e Shengjergjit ose e Bletes	45	Rrapi i Tragjasit te Vjeter
20	Shpella e Ramices	46	Rrapi i Shenvarvares (Velçe)
21	Shpella e Velçes	47	Rrapi i Gurrave Smokthine
22	Shpellat e Boderit (Smokthine)	48	Rrapi i Madh ne Bashaj

23	Shpella e Haxhi Alise (Iliriane)	49	Rrepet e Drashovices
24	Shpella e shkruar	50	Ullinjte e Trubullit ne Karbunare
25	Shpella e Bilbilenjeve	51	Pylli i Zvernecit
26	Shpella e Porto Palermos		

Gjendja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

AKM ka publikuar raportin e Gjendjes në Mjedis prej vitesh i cili ka prezantuar gjendjen e mjedisit në përgjithësi dhe të cilësisë së ajrit urban në veçanti duke ofruar një vlerësim real bazuar në të dhënat ekzistuese nga sistemet e monitorimit të cilësisë së ajrit .

Cilësia e ajrit ne vendin tone

Gjëndja e cilesisë së ajrit është një nga cështjet kryesore që shqetëson autoritetet lokale dhe kombëtare për impaktin që ka në shëndetin e popullatës ,bujqësisë dhe mjedisit në përgjithësi. Kushtet e jetesës së njeriut janë direkt të varur nga ekosistem në të cilin ai jeton, kështu që është e nevojshme për të mbrojtur dhe për të ruajtur mjedisin si dhe për të siguruar një cilësi të qëndrueshme të jetës për gjeneratat e tashme dhe të ardhshme.



Gjatë viteve të fundit konteksti ligjor i BE-së dhe legjislacioni kombëtar i cili transposon direktivae e BE per ajrin urban na ndihmon te përcaktojnë veprimet e nevojshme për të përmirësuar cilësinë e ajrit në bazë të identifikimitt e kritereve të reja për kontrollin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në nivel lokal dhe kombëtar. Rrjeti i monitorimit të cilësise së ajrit në Shqipëri përfshin qytetet kryesore si Tirana, Elbasan, Durrës, Fier, Vlora, Shkodra, Korçë dhe monitorimi është realizuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit per periudhen kohore shkurt-dhjetore 2016 për indikatoret kryesorë të cilësisë së ajrit.

Kuadri i politikave të BE-së është i fokusuar kryesisht në dy pika kryesore: ku njëra është identifikimi i vlerës kufi për ndotësve te ajrit të orientuara në mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe ekosistemeve, dhe nga ana tjetër zhvillimin e një plani të koordinuar të kontrollit dhe të menaxhimit te cilësisë së ajrit. Direktivat të BE-së në cilësinë e ajrit, transpozuar në legjislacionin kombëtar me anë të ligjit 162/2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së

ajrit të ambientit" dhe dekretet e zbatimit të saj e paraqesin problemin e ndotjes së ajrit si një fenomen dinamik që është e nevojshme te menaxhohet.

Tabela nr 3 Normat e BE për ajrin urban

Normat e BE	PM_{10} µg/m³	$PM_{2.5}$ µg/m³	SO_2 µg/m³	O_3 µg/m³	CO mg/m³	NO_2 µg/m³	Benzeni µg/m³
1 orëshe			350			200	
8 orëshe				120	10		
24 orëshe	50		125				
Vjetor	40	25				40	5

Të dhënat e PM_{10}

Grafiku 1. Vlerat mujore të PM10



Referuar të dhënave mujore të monitoruara vërejmë se vlerat më të larta janë monitoruar në periudhën Janar-Shkurt dhe Nëntor –Dhjetor sidomos në stacionin e Korçës. Vlera më e lartë në këtë stacion është regjistruar në Dhjetor dhe kjo vlerë është 109.63 µg/m³.Gjithashtu kemi tejkalim në muajt Janar dhe Shkurt ku vlerat e monitoruara janë 74.24 µg/m³ dhe 46.04 µg/m³, si dhe nentor ku vlera e monitoruar është 66.55 µg/m³.Referuar muajve të tjerë të vitit theksojmë se vlerat e monitoruara janë nën normë gjë që ka ndikuar dhe në vleren mesatare vjetore e cila është nën normen e BE.

Meqënse vlerat më të larta janë monitoruar në sezonin e dimrit ku dhe temperaturat e ajrit janë shumë të ulëta mendohet që burimi kryesor i ndotjes së ajrit në qytetin e Korçës është përdorimi i lëndës djegëse për ngrohjen e banesave. Kjo vlerësohet dhe për arsyen se stacioni është i instaluar në zonë të banueshme larg qëndrës dhe trafikut.

Gjithashtu kemi tejkalim dhe në stacionin e Durrësit ne muajin dhjetor ku vlera e monitoruar është 55.07 µg/m³, në stacionin e Elbasanit në periudhën janar-shkurt dhe dhjetor ku vlerat e monitoruara janë 84.52 µg/m³ , 55.08 µg/m³ dhe 49.18 µg/m³.

Kemi tejkalim në stacionin e Tiranës ATSH në periudhën Janar- Shkurt dhe Nentor ku vlerat e monitoruara janë 66.89 µg/m³ , 63.54 µg/m³ dhe 45.53 µg/m³ ne stacionin e Tirana AKM kemi tejkalim në të gjithë muajt e vitit me përjashtim të periudhës Korrik-Gusht . Ndërsa në

stacionin e Shkodrës dhe të Vlorës kemi tejkalim vetëm në muajin Dhjetor ku vlerat e monitoruara janë 45.3 µg/m³ dhe 53.24 µg/m³.

Grafiku 2 Mesataret vjetore të PM_{10}



Bazuar në të dhënat mesatare te monitoruara për vitin 2016 theksojmë se nivelet më të larta të PM_{10} janë monitoruar në stacionet e Tirana AKM dhe Tirana ATSH ku kemi tejkalim të normës vjetore të BE në masen 15% për Tirana ATSH dhe 38% për Tirana AKM. Ne stacionin e ATSH (Ministria e Mjedisit) vlera vjetore e monitoruar është 46.01 µg/m³ krahasuar me normën vjetore është 40 µg/m³ pra kemi tejkalim me 6.01 µg/m³ ndërsa në stacionin e AKM vlera vjetore e monitoruar është 55.25 µg/m³ dhe krahasuar me normën vjetore kemi tejkalim me 15.25 µg/m³. Në stacionin e Korçës dhe Elbasanit vlerat vjetore të monitoruara përafrohen me normën e BE po pa e tejkaluar, këto vlera janë 37.66 µg/m³ në stacionin e Korçës dhe 38.67 µg/m³ në stacionin e Elbasanit. Në stacionin e Durrësit , Shkodrës dhe Vlorës vlerat mesatare vjetore të monitoruara janë nën normen e BE dhe vlerat mesatare janë 24.03 µg/m³ në Durrës , 16.63 µg/m³ në Shkodër dhe 23.06 µg/m³ në Vlorë.

Grafiku 3 Numri i ditëve që tejkalojnë normën e ditëve të lejuara për PM_{10}



Një nga treguesit kryesore te cilësise së ajrit urban për PM_{10} është edhe numri i ditëve që tejkalon normen ditore të BE prej 50 µg/m³ nga numri i ditëve të lejuara në një vit që është

35 ditë.Bazuar në të dhënat statistikore për numrin e ditëve që tejkalojnë normën ditore të PM_{10} vërejme se kemi tejkalim në stacionin e Korçës ku kemi tejkalim 65 ditë në vit dhe Tirana AKM ku kemi tejkalim 76 në vit nga 35 ditë që numri i ditëvë të lejuar në një vit. Kemi përafrim të numrit të ditëve të lejuar në vit për stacionin e Durrësit dhe Elbasanit. Ndërsa në stacionin e Shkodrës, Vlorës dhe Tirana ATSH numri i ditëve që tejkalojne normën ditore të BE është i ulët.

Tabela nr 4 Numri i ditëve që tejkalojnë normën ditore te PM_{10} prej 50 µg/m³

Viti 2016 PM_{10}	Numri i ditëve që tejkalojnë normen ditore të BE (50µg/m³)	Nr. ditëve të lejuar/vit
Durrës	34 ditë /341 ditë monitorimi	35
Elbasan	34 dite /230 dite monitorimi	35
Shkodër	10 dite /253 dite monitorimi	35
Vlorë	24 dite /341 dite monitorimi	35
Korçë	65 dite /357 dite monitorimi	35
AKM	76 dite /167 dite monitorimi	35
Tirana Mobile (ATSH)	21 dite /104 dite monitorimi	35

Të dhënat e $PM_{2.5}$

Grafiku 4. Vlerat mujore të PM2.5



Monitorimi i $PM_{2.5}$ kryhet në 4 stacione monitorimi në Durrës, Shkodër, Vlorë dhe Korçë. Nga të dhënat të paraqitura dhe në formë grafike vërejmë se nivelet më të larta të $PM_{2.5}$ janë monitoruar në stacionin e Korçës në periudhën Janar-Shkurt dhe Nentor Dhjetor dhe vlerat mujore janë 62.54 µg/m³ në muajin Janar dhe 33.92 µg/m³ në muajin Shkurt. Në muajin Nentor-Dhjetor vlerat e monitoruara janë 46.32 µg/m³ dhe 80.08 µg/m³. Gjithashtu kemi tejkalim të normës vjetore të $PM_{2.5}$ në stacionin e Durrësit në muajin Janar dhe Dhjetor ku vlerat e monitoruara janë 29.51 µg/m³ dhe 32.97 µg/m³ si dhe ne stacionin e Shkodrës ne muajin Dhjetor ku vlera e monitoruar është 42.58 µg/m³. Referuar vlerave mesatare vjetore për $PM_{2.5}$ kemi tejkalim të normës vjetore per 25 µg/m³ në stacionin e Korçës në masën 4% ku vlera e monitoruar është 25.96 µg/m³. Tejkalimi është në një përqindje shumë të vogël po problematik mbetet në periudhën e dimrit ku tejkalimi arrin disa herë mbi normë.
Në stacionet e Durrësit, Shkodrës dhe Vlorës vlerat vjetore të monitoruara janë afersisht 50% më të ulëta se norma e BE dhe ndotja e ajrit nga $PM_{2.5}$ në zonën pranë stacioneve të monitorimit nuk përbën ndonje problem.

Grafiku 5 Mesataret vjetore të $PM_{2.5}$



Të dhënat e NO_2

Grafiku 6 Vlerat mujore të NO2



Monitorimi i NO_2 për vitin 2016 është realizura në 6 stacione , Durrës, Elbasan, Korçë,Tirana ATSH, Shkodër, dhe Vlorë. Referuar të dhënave mujore siç vihet re dhe nga grafiku kemi tejkalim të normës së BE në stacionin e Tirana ATSH në muajin Shkurt ku vlera e monitoruar është 42.36 µg/m³ dhe në stacionin e Durrësit në muajin Dhjetor ku vlera e monitoruar është 41.78 µg/m³ nga 40 µg/m³ që është norma vjetore e BE.

Grafiku 7 Mesataret vjetore të NO_2



Bazuar në të dhenat mesatare vjetore të monitoruara në stacionet e sipërpërmendura rezulton se nuk kemi tejkalim të vlerës limite vjetore të BE në asnje nga stacionet e monitoruara.Vlerat më të larta vjetore janë monitoruar në stacionin e Tirana ATSH ku vlera e monitoruar është 30.18 µg/m³ në Elbasan me 26.41 µg/m³ dhe Durrës. 24.49 µg/m³. Kjo është e pritshme se të tre stacionet janë stacione të instaluara pranë rrugëve kryesore dhe me burim ndotjeje trafikun.

Të dhënat e SO_2

Grafiku 8 Vlerat mujore te SO2



Grafiku 9 Mesataret vjetore te SO2



Përsa i përkët SO_2 nuk kemi tejkalim të vleres limite të BE në asnjë nga stacionet e monitoruara,vlera më e lartë është monitoruar në stacionin Tirana ATSH dhe është 13.56 µg/m³. Vlera më e lartë mujore është monitoruar në këtë stacion në muajin Gusht dhe është 27.84 µg/m³.

Të dhënat e O_3

Grafiku 10 Vlerat mujore të O3



Grafiku 11 Mesataret vjetore të O_3



Monitorimi i O_3 është realizur në 6 stacione si Durrës, Elbasan, Korçë ,Tirana ATSH, Shkodër, dhe Vlore. Vlerat më të larta vjetore jane monitoruar në stacionin e Shkodres dhe Vlorës ku vlerast janë 66.93 µg/m³ në Stacionin e Shkodrës dhe 63.34 µg/m³ në stacionin e Vlorës. Referuar të dhënave mujore vlerat më të larta janë monitoruar në sezonin e verës e sidomos në muajin Gusht. Në ndryshim nga ndotësit e tjerë niveli i ozonit në pergjithësi është më i larte në stacionet urban background ndërsa I ulet ne stacionet e trafikut .Nivelet e larta të Ozonit në stacionet urban backgroung ndodhin për shkak të temperaturave të larta dhe të niveleve të larta të rrezatimit diellor. Përsa i përket vlerave 8 orare të ozonit theksojmë se kemi tejkalim të normës 8 orare prej 120 µg/m³ në dy stacionet e sipërpërmendura. Numri I vlerave 8 orare që tejkalojne normën 8 orare për stacionin e Shkodrës është 59 dhe në stacionin e Vlorës është 36. (tabela në vijim).

Shkodër	**Numri ivlerave 8 orare që tejkalojnë normen e BE prej 120 µg/m³**	**Vlorë**	**Numri I vlerave 8 orare që tejkalojnë normen e BE prej 120 µg/m³**
8.08.2016	3	23.07.2016	3
10.08.2016	3	1.08.2016	2
11.08.2016	7	5.08.2016	2
21.08.2016	3	6.08.2016	3
27.08.2016	6	14.08.2016	4
28.08.2016	5	15.08.2016	4
29.08.2016	3	27.08.2016	6
31.08.2016	7	2.09.2016	2
1.09.2016	5	3.09.2016	2
3.09.2016	5	4.09.2016	8
4.09.2016	7		**36**
5.09.2016	5		
	59		

Të dhënat e CO

Grafiku 16 Vlerat mujore të CO



Grafiku 17 Mesataret vjetore të CO



Monitorimi i CO është realizur në 6 stacione si Durrës, Elbasan, Korçë ,Tirana ATSH, Shkodër, dhe Vlorë. Në asnjë nga stacionet e monitoruara nuk kemi tejkalim të normës së BE .Vlerat më të larta mujore janë monitoruar në stacionin e Korçës në muajin Janar dhe Dhjetor. Referuar dhe vlerave 8 orare theksojmë se nuk kemi tejkalim të normës 8 orare prej 10 µg/m³.

Të dhënat e Benzenit

Grafiku 18. Vlerat mujore të benzenit



Grafiku 19 Mesataret vjetore të Benzenit



Ashtu si edhe treguesit e tjerë monitorimi i Benzenit është realizur në 6 stacione.Vlera mesatare vjetore më e lartë është monitoruar në stacionin e Korçës dhe është 4.19 µg/m³ nga 5 µg/m³ që është norma vjetore e BE pra kemi përafrim të normës vjetore por pa e tejkaluar atë.Vlerat më të larta mujore janë monitoruar në, ndërsa në stacionet e tjera vlerat mesataret vjetore jane më te ulta se norma vjetore e BE.

- stacionin e Korçës në periudhen Janar –Shkurt dhe Dhjetor ku vlerat e monitoruara janë 18.17 µg/m³, 7.73 µg/m³ dhe 10.5 µg/m³.

-në stacionin Mobile (ATSH) në Janar ku vlera e monitoruar është 14.08 µg/m³.

-në stacionin e Shkodrës në Janar dhe Dhjetor ku vlerat e monitoruara janë 6.12 µg/m³ dhe 7.61 µg/m³.

Cilesia e lumenjeve

Monitorimi i cilësisë së ujit është i rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e ujërave, identifikimin e shkaktarëve të ndotjes deri në dhënien e rekomandimeve përkatëse sipas problematikave të identifikuara. Ky program monitorimi me një frekuencë 4 herë/vit siguron një bazë të dhënash të cilat përdoren në hartimin e Raportit të Gjëndjes së Mjedisit, në hartimin e informacioneve në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar, si dhe raportimet në Agjencinë Europiane të Mjedisit.

Gjëndja e treguesve mjedisor, ndikimi në mjedis dhe tendenca

Rrjeti i monitorimit është i shtrirë në lumenj, liqene dhe zona bregdetare. Monitorimi është realizuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit per periudhen kohore shkurt-dhjetor 2016, me frekuencë 4 herë në vit për ujërat e lumenjve, liqeneve dhe zonave bregdetare për përcaktimin e nutrientëve dhe 2 - 3 herë në vit për përcaktimin e klorofilës a në liqene.

Klasifikimi i cilësisë së lumenjve dhe liqeneve përcaktohet në bazë të parametrave fiziko-kimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE. Për klasifikimin e zonave bregdetare i referohemi VKM 177 dt. 31.03.2005 - Normat e lejuara të shkarkimeve urbane nga impiantet e trajtimit.

Parametrat e analizuar në laborator

- Nevoja Biokimike për oksigjen mg/l



- Nevoja kimike per oksigjen

Nevoja kimike për oksigjen është tregues I ndotjes kimike dhe organike, ku te dhenat e monitorimit jane paraqitur ne grafikun si vijon



- Përmbajtja e amoniakut

Përcaktimi i përmbajtjes së amoniakut në kampione uji i përcaktuar me metodën spektrometrike është parametër kryesor i klasifikimit në klasa të cilësisë së ujërave sipas DKU. Referuar te dhenave te marra nga 4 ekspeditat e kryera paraqitja grafike shpreh qarte stacionet te cilat rezultojne te jene mbi normen e lejuar.



♦ Përmbajtja e nitriteve



♦ Përmbajtja e nitrateve

Përmbajtja e nitrateve në te gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më te ulëta se norma e lejuar(<0.8mg/l).



♦ Përmbajtja e fosforit

Referuar vlerave mesatare, sic janë paraqitur edhe në grafikun e mëposhtëm, Baseni i Drinit paraqet ujëra me gjendje të lartë – Klasa I ku vetëm stacioni Drin Lezhë klasifikohet në Klasën II me vlerë 0.062 mg/l.



Përmbajtja e fosforit total

Në tabelën si vijon paraqitet klasifikimi i cilësisë së baseneve për vitin 2016.

Klasifikimi i cilësisë së lumenjve dhe klasifikimi i baseneve
Në tabelën si vijon paraqitet klasifikimi i cilësisë së baseneve për vitin 2016.

Cilësia	Baseni Drini - Bunë	Baseni Ishëm - Erzen	Baseni i Shkumbinit	Baseni i Semanit	Baseni i Vjoses	Baseni i Matit
Klasa I – Gjendje e larte						
Klasa II – Gjendje e mire					II	
Klasa III – Gjendje e moderuar			III			III
Klasa IV – Gjendje e varfer	IV					
Klasa V – Gjendje e keqe		V		V		

Baseni Ishëm – Erzen janë basenet më të ndotura të cilat klasifikohen në Klasën V – Gjëndje e keqe.

Baseni i Shkumbinit është një basen me cilësi – gjëndje e moderuar ku impakt të madh ndotjeje kanë stacionet e Paprit dhe Rrogozhinës të cilat e klasifikojnë këtë basen në klasën III.

Baseni i Matit vlerësohet në gjendje të moderuar – Klasa II.

Trendi i cilësisë së baseneve 2014 - 2016

Nr.	Baseni	Klasifikimi 2014	Klasifikimi 2015	Klasifikimi 2016	Komente
1.	Baseni Drini – Bunë	III Gjëndje e moderuar	III Gjëndje e moderuar	IV Gjëndje e varfër	Ndotja vjen si rrjedhojë e shkarkimeve të qytetit të Lezhës. Përmirësimi i cilësisë së ujërave të këtyre lumenjve lidhet me mënjanimin e shkarkimeve urbane dhe industriale në këto ujëra.
	Baseni Drini Lezhë	IV Gjëndje e varfër	IV Gjëndje e varfër	IV Gjëndje e varfër	
2.	Baseni Ishëm – Erzen	V Gëndje shumë e keqe	V Gjendje shumë e keqe	V Gjëndje shumë e keqe	Situata paraqitet problematike ndër vite ku dëshmi e qartë janë shkarkimet e lëngëta urbane të patrajtuara si dhe shkarkimet industriale të subjekteve të zonës së autostradës.
3.	Baseni i Shkumbinit	III Gjëndje e modëruar	IV Gjëndje e keqe	III Gjëndje e moderuar	Kemi një përmirësim të cilësisë së ujërave të këtij baseni për vitin 2016 krahasuar kjo me vitin 2015.
4.	Baseni i Semanit	V Gjëndje shumë e keqe	V Gjëndje shume e keqe	V Gjëndje shumë e keqe	Lumi i Gjanicës ndikon dukshëm në cilësinë e këtij baseni ku klasifikohet në lumenjtë më tëndotur, si pasojë e ndikimit dhe presionit të shkarkimeve urbane dhe industriale ku edhe për vitin 2016 gjëndja vazhdon të jetë njësoj.
5.	Baseni i Matit	II Gjëndje e mirë	III Gjëndje e moderuar	III Gjëndje e moderuar	Cilësia e këtij baseni vazhdon të jetë në gjëndje të moderuar si pasojë e ndikimit të shkarkimeve urbane.
6.	Baseni i Vjosës	II Gjëndje e mirë	II Gjëndje e mirë	II Gjëndje e mirë	Cilësia e këtij baseni paraqet ujëra në gjëndje të mirë.

Cilësia e ujërave nëntokësorë
Monitorimi i ujrave nëntokësore është realizuar nga **SHGJSH në basenet e Drinit, Matit, Erzen - Ishmit, Shkumbinit, Semanit, Vjosës e Zonës Jonike ne periudhen kohore shkurt dhjetor 2016.**
Monitorimi synon ruajtjen e tregueseve sasiorë e cilësorë të ujit, të rezervave të shfrytëzimit, mbrojtjen e vendburimeve ekzistuese të ujit, si dhe vlerësimin e shkaqeve të ndotjes së ujrave nëntokësore. Në përfundim të monitorimit jepen rekomandimet për

gjendjen aktuale të cilësisë së ujrave, trendet e përmirësimit ose përkeqësimit të cilësisë si masat për mbrojtjen e tyre si zbatimin e zonave të rreptësisë dhe të mbrojtjes sanitare, shkallen e shfrytezimit etj. etj. Monitorimi i ndotjes së ujrave nëntokësore ka siguruar vijueshmërinë nga viti 2000 - 2016 në akuiferët porozë të Kuaternarit në 7 basenet ujëmbajtëse. Vlerësimi dhe zbatimi i monitorimit të UN është vlerësim dhe mbrojtje për pasurinë më të madhe kombëtare – **UJIN** duke e bërë monitorimin një disiplinë të re dhe shkencore që garanton:

- Ruajtjen e rezervave të shfrytëzimit të UN
- Mbrojtjen e vendburimeve ekzistuese të ujit
- Vlerëson shkaqet e ndotjes së UN

Jep rekomandime për zbatimin e zonave të rreptësise dhe mbrojtjes sanitare e në bashkëpunim me organet kompetente të marrë masa ndëshkuese për këto probleme.
Monitorimi i UN gjatë vitit 2016 është kryer nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptare financuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, në 7 basenet ujëmbajtëse për akuiferet porozë të kuaternarit : Shkodër, Lezhë, Fushë - Kuqe, Tiranë, Fushë - Krujë, Elbasan, Lushnjë, Berat, Korcë, Gjirokastër, Kafaraj, Novoselë, Vurg - Mursi e Orikum. Gjithashtu u monitoruan 11 burime kryesore të akuiferit karbonatik në basenin e Drinit - burimi Syri i Sheganit, burimi Gurra e Kolesjanit, burimi Tushemisht, burimi i Linit, në basenin e Matit - burimi i Bargjanës, në basenin e Semanit - burimi i Mançurishtit, burimi i Urës Vajgurore, burimi i Bogovës, në basenin e Zonës Jonike - burimi Syri i Kaltër, burimi Uji i Ftohtë Tepelenë dhe burimi Uji I Ftohtë Vlorë. Ky monitorim është kryer sipas Kontratë Porosisë së lidhur ndërmjet Agjensisë Kombëtare të Mjedisit dhe Shërbimit Gjeologjik Shqipëtar për vitin 2016. Për monitorimin e kryer jepen rezultatet në tabela për vitin 2016 dhe në tabelat 5 vjeçare për çdo basen dhe janë paraqitur në mënyrë grafike këto tregues krahasuar me normat e vendit tonë dhe të BE. Jepen ndryshimet stinore, tejkalimet e treguesve mbi normë dhe rekomandimet në përputhje me VKM.

Burimi i informacionit: Raporti i gjendjes se mjedisit per vitin 2016, Ministria e Mjedisit, Agjencia Kombetare e mjedisit(Faqja Zyrtare).

4. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS.

Pershkrim i shkurter i aktivitetit

Aktiviteti konsiston ne perpunimin dhe lyerjen e strukturave metalike, i ndodhur ne Qarkun Vlore, Bashkia Vlore, Rruga Industriale, Zona Industriale Soda. Ky aktivitet ne teresine e tij perbehet nga nje proces pune i thjeshte i cili sqarohet ne menyre te permbledhur si me poshte:

Lenda e pare qe Perpunohet

1. Tabak Metalik qe mund te jene: Llamarine Alumin, Inox, Dekape, Zingato, Alumin
2. Tub, Profil Metalik qe mund te jene: Alumin, Inox, Dekape, Zingato, Alumin
3. Strico (Lame) Metalike qe mund te jene: Baker, Alumin, Inox, Celik.

Lendet e para furnizohen nga subjekte te ndryshme.
Lendet e Para Llamarine Dekape, Zingato, Tub (Profile Metalik) Dekape, Zingato furnizohen nga: "Papmetal" Shpk Xhaf Zotaj Durres, "AlbSteel" Shpk Xhaf Zotaj Durres, "Kerri" Shpk Mucaj-Vore.
Lendet e Para Llamarine Inox, Alumin furnizohen nga "ItalInox Shqiperia" Shpk Durres.
Lendet e Para Strico (Lame) Brrek importohen nga GEMCILER S.A.S Turqi.
Lenda e Pare Boje Elektrostatike Ekologjike shoqerohet me certifikate dhe analiza furnizohet nga "Neon" Shpk Tirane, "Tecol Albania" Shpk Tirane.

Magazinimi i Lendeve te para

Lendet e para te furnizuara gjate marrjes ne dorezim iventarizohen nga stafi yne. Ato kontrollohen per gjendjen fizike te tyre nese plotesojne standardin e kerkuar. Ato magazinohen ne rafte te realizuar posacerisht ne ambiente te pastra dhe te thata. Ne rast verejtje problematike njoftohet furnitori me E-mail. Lendet e para si Boje Pluhur Automat TM, TU, Bulloneri etj magazinohen ne rafte dhe nuk hapen kutite. Ato nxirren nga kutite vetem ne momentin e venies ne pune te tyre.

Proceset e Perpunimit

Te gjitha makinerite dhe pajisjet qe disponojme jane te markes dhe me certifikate "CE", jane te pajisura me sensore elektromekanik, sensor akustik, sistem ventilimi, sistem ajrimi, sistem ftohes lubrifikues apo transformatoresh me efekte akustik minimal me sisteme servomotore & starter.
1. Procesi i prerjes se tabakeve nis nga projektimi ne Autocad per te minimizuar mbetjet. Prerja behet me makineri me Kontroll Numerik CNC, "CE" me Punson + Matrize.
2. Procesi i perthyerjes se fletes behet duke zbatuar projektin nga Autocad, me makineri me Kontroll Numerik CNC, "CE".
3. Procesi i prerjes se tubit, profilit, stricos behet ne te ftohte me sharre ose me prese. Shpimi dhe birimi i tyre behet ne prese, mbetjet jane ne forme katrore, rrethore ose ovale, ato ndahen qe ne origjine sipas llojit te metalit.
4. Procesi i bashkimit te elementeve mund te kryhet : a) Me saldimim saldatrice, saldimi me fill te vazhduar, b) Me aparat saldimi me kontakt elektrik (puntatrice elektrike), c) Me saldatrice tig me elektrode tungstel, d) Me bashkim elementesh me riveto + bullon, ribatinim. Lendet e para per saldature furnizohen nga: "Bota e Saldimeve" Shpk Tirane,

"Tecnosald Vjen" Shpk Durres. Lenda e pare Gaz per saldatura e prerje furnizohet nga "GTS" Shpk Tirane .
5. Procesi kryhet me makineri dore te markes HILTI, behet me xhiro te kontrolluara per mos te ndryshuar cilesite ne pjesen qe pastrohet, ferkohet duke krijuar sa me pak mbetje teknologjike. Disqet e pastrimit jane te makres HILTI, kur ato konsumohen i dorezohen furnitorit.
6. Pas procesit te pastrimit te strukturave metalike behet lyerja e tyre.
7. Strukturat metalike pas procesit te lyerjes futen nje nje furre ne te cilen behet tharja e tyre. Furra funksionon me lende djegese gas.

Mbetjet qe krijohen nga procesi i perpunimit te strukturave metalike jane: Copeza metali hekuri, llamarine, pluhur metali ferroz, te cilat ruhen dhe magazinohen ne kontenier metalik te vecante. Keto mbetje metalike shiten per skrap, dorezohen tek subjekti Hiqmet Lelaj (person Fizik) Vlore, i cili eshte i licencuar per grumbullimin, tranportimin dhe riciklimin e ketyre mbetjeve.

Per kryerjen e proceseve teknologjike punonjesit e kompanise tone jane trajnuar nga kompani shqiptare dhe te huaja per kryerjen e proceve te punes me eficence te larte, respektimin e standardeve te kerkuara ne prodhim sipas kartes teknologjike te produktit, standardit dhe te qenit sa me miqesore ndaj mjedisit.
Gjate kryerjes se proceseve te punes punonjesit jane te pajisur me uniforma pune, dorashka pune sipas procesit, futa meshine, maska saldimi, maska axhustimi, kufje, etj. Ne procesin e lyerjes me elektrostatik perdoren maska frymemarje (nje perdorim).
Lenda e pare djegese per kaldajen e furres te lyerjes se metaleve eshte Gaz, i cili furnizohet furnizohet nga "Ceno Gaz" Shpk Vore. Cdo furnizim ne depoziten 3000 litra shoqerohet me certifikate dhe analiza. Ambjentet e jashtme dhe te brendshme jane te pajisura me tabela drejtuse, sinjalizuse dhe parandaluese.
Ne ambjentet e prodhimit ndalohet rreptesisht hyrja e personave te pa autorizuar. Vizitoret qe lejohen te hyjne pajisen me karte vizitori dhe shoqerohen nga stafi yne.
Produkti perfundimtar ambalazhohet ne kuti kartoni (kutite e kartonit furnizohen nga subjekti "Euro Kartoni" Shpk Fier. Kompania jone vazhdimisht merr masa per te qene sa me miqesor me mjedisin perreth duke mbjelle peme halore dhe duke gjelberuar mjediset ne territorin ku zhvillon aktivitetin, duke mbajtur paster dhe mos krijuar ndotje dhe shqetesime ne ambjentet qe disponon dhe perreth saj.
Ne ambjentet e brendshme eshte krijuar ambulanca Rjepaj Elektromekanika, ku mjeku i punesuar nga subjekti ndjek shendetin e punonjesve si dhe pastertine e ambjenteve te punes.

Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)
Vleresimi i ndikimeve ne mjedis kryhet duke u bazuar mbi parimet e mbrojtjes se mjedisit te cilat jane:

- Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- Parimi i qasjes së integruar
- Parimi i përgjegjësisë së ndërsjellë dhe bashkëpunimit

Parimi "Ndotësi paguan"
Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 "Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis" dhe ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 686, date 29.07.2015 "Per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis" dhe ka si synim idnetifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e dëmtimi. Kjo përbën përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për çdo banor të Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Objektivat e mbrojtjes së mjedisit janë:

a) Parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera;
b) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
c) Ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
d) Përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
e) Ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
f) Mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit;
g) Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut:

Ndikime te rendesishme gjate funksionimit te aktivitetit.

Shkarkime ne uje

Nuk kemi shkarkim te ujerave teknologjike. Nuk kemi proces te larjes se strukturave metalike. Ne proceset e punes te ketij aktiviteti nuk merr pjese uji. Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujera higjenosanitare te cilat shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones.

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer nga ky instalim mund te vijne vetem nga proçeset e lyerjes me boje, por vetem ne ambjentin e punes, pasi sistemi i lyerjes eshte i mbyllur me cikel riqarkullues te bojes. Vete roboti i lyerjes kryen nje riqarkullim te pluhurit te bojes, duke e filtruar ate dhe duke e rifutur ne proçesin e prodhimit.

Pluhurit te bojes se thithur, i kryhet nje filtrim para riperdorimit, me qellim mos humbjen e cilesise se lyerjes. Bojen e mbetur ne fund te filtrit si te nje cilesie jo shume te mire, administratori e riperdor per lyerje te produkteve dytesore, pra per nje cilesi te dores te dyte. Ne parim, nuk ka mbetje te bojes, riperdoret dhe riciklohet ne sistemin e lyerjes.

Shkarkime te tjera vleresohen edhe lenda djegese e kaldajes se furres per tharjen e bojes. Ky sistem funksionon me lende djegese Gas (GLN). Nga djegia e gazit natyror, permbajtja e tij Propan çlirohet gaz CO_2.

Reaksioni kimik ekzotermik i cili ndodh gjate djegies se gazit propan eshte si me poshte:

$$C_3H_8 + 5O_2 \rightarrow 3CO_2 + 4\ H_2O + \text{nxehtesi}$$

Siç shihet edhe ne reaksionin kimik me siper, nga bashkeveprimi i Propanit me Oksigjenin gjate djegies çlirohet Dioksid Karboni, Uje dhe nxehtesi.

Djegia e propanit është shumë më e pastër se djegia e benzinës, megjithëse jo aq e pastër sa djegia e gazit natyror. Prania e lidhjeve C-C, plus lidhjet e shumta të propilenit dhe butilenit,

krijojnë shkarkime organike përveç dioksidit të karbonit dhe avujve të ujit gjatë djegies tipike. Këto lidhje gjithashtu bëjnë që propani të digjet me një flakë të dukshme.
Propani është një asfiksant i thjeshtë. Ndryshe nga gazi natyror, propani është më i dendur se ajri. Mund të grumbullohet në hapësira të ulëta dhe afër dyshemesë. Kur abuzohet si inhalues, mund të shkaktojë hipoksi (mungesë oksigjeni), pneumoni, dështim të zemrës ose arrest kardiak. Propanët kanë toksicitet të ulët pasi nuk absorbohen lehtë dhe nuk janë biologjikisht aktive. Ruajtur zakonisht nën presion në temperaturën e dhomës, propani dhe përzierjet e tij avullojnë në presion atmosferik dhe ftohen mirë nën pikën e ngrirjes së ujit. Gazi i ftohtë, i cili duket i bardhë për shkak të kondensimit të lagështirës nga ajri, mund të shkaktojë ngrirje. Propani është më i dendur se ajri. Nëse ndodh një rrjedhje në një sistem të karburantit të propanit, gazi do të ketë një tendencë të zhytet në çdo zonë të mbyllur dhe kështu paraqet rrezik për shpërthim dhe zjarr.

Zhurmat dhe vibrimet
Zhurmat qe prodhohen ne kete aktivitet vijne kryesisht nga makinerite prerese te profileve metalike, si dhe makinerite zmeriluzuese. Proçesi i prodhimit shoqerohet me çlirim zhurme, por keto zhurma mbeten brenda ambjentit te punes, nuk vleresohet ne nivele te tilla sa qe te jene e shqetesuese per zonen, madje, ne ambjentet e jashtme te repartit, keto zhurma jane te pandjeshme. Punonjesit e ekspozuar ndaj burimeve te zhurmes, duhet qe te perdorin vazhdimisht kufje mbrojtese por edhe te mos punojne me orare te zgjatura, rekomandohet deri ne gjashte ore ne nje dite pune. Vibrime nga ky aktivitet nuk vleresohet te kete. Nuk ka mullinj, nuk ka rula te medhenj rrotullues, nuk ka punime me çekiçe pneumatike, etj.

Ndikimi ne toke
Proceset e punes nuk ndikojne ne toke per shkak te ambjenteve te pershtatshme e bashkekohore, te shtruara me beton dhe per shkak se nuk shkarkohen ujera te perdorura ne mjedisin e zones. Nisur nga fakti se nuk ka shkarkime ne toke, shkarkime te ujerave te perdorura, mbetje te ngurta per tu hedhur (mbetjet metalike dergohen te gjitha per riciklim, shiten), as shkarkime ne ajer te cilat te depozitohen ne tokat perreth, arrijme ne konkluzionin se aktiviteti nuk ndikon ne toke. Objekti eshte i ndertuar.

Ndikimi ne Biodiversitet
Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonn te mbrojtur. Lloji i aktivitetit per vendodhjen qe ka nuk ndikon ne demtimin e biodiversitetit te zones. Nuk ka shkarkime te ujerave te perdorura, nuk ka shkarkime te mbetjeve te ngurta as te gazeve te demshme ne ajer, me perjashtim te lendes djegese gazit GLN. Objekti ndodhet ne zone industriale dhe nuk prek biodiversitetin e zones.

Ndikimi ne Mjedisin Social
Ndikimi i ketij aktiviteti ne mjedisin social, eshte pozitiv persa i perkete punesimit, sherbimit te prodhimit e shitjes se ketyre produkteve.

Mbetjet e prodhuara
Mbetjet qe prodhohen ne kete aktivitet jane: Copeza metali hekuri, llamarine, pluhur metali ferroz, nga aktiviteti human, mbetje urbane te tilla si: mbetje plastike, qelqi, qese dhe kartona nga ambalazhet, etj. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta, pasi materiali

eshte 100% i perdorshem, si pluhuri metalit si copezat shiten per skrap, dergohen per riciklim ne kompanite e licensuara per kete qellim (Subjekti "Hiqmet Lelaj" P.F Vlore).

Klasifikimi i ketyre mbetjeve sipas Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve eshte si me poshte:

Mbetjet industriale nga aktiviteti

12 01 01	Tallash të metaleve ferrore (Mbetje jo te rrezikshme)
12 01 02	Pluhur dhe pjesë të imëta të metaleve ferrore (Mbetje jo te rrezikshme)

Mbetjet urbane nga aktiviteti human

20 01 01	Letër dhe karton
20 01 02	Qelq
20 01 39	Plastikët
20 01 40	Metalet

5. PËRSHKRIM I SHKARKIMEVE TË MUNDSHME NË MJEDIS.

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Nuk kemi shkarkim te ujerave teknologjike. Nuk kemi proces te larjes se strukturave metalike. Ne proceset e punes te ketij aktiviteti nuk merr pjese uji. Ujerat qe dalin nga aktiviteti jane ujera higjenosanitare te cilat shkarkohen ne sistemin e kanalizimeve te zones.

Emetimet ne ajer nga ky instalim mund te vijne vetem nga proçeset e lyerjes me boje, por vetem ne ambjentin e punes, pasi sistemi i lyerjes eshte i mbyllur me cikel riqarkullues te bojes. Vete roboti i lyerjes kryen nje riqarkullim te pluhurit te bojes, duke e filtruar ate dhe duke e rifutur ne proçesin e prodhimit. Pluhurit te bojes se thithur, i kryhet nje filtrim para riperdorimit, me qellim mos humbjen e cilesise se lyerjes. Bojen e mbetur ne fund te filtrit si te nje cilesie jo shume te mire, administratori e riperdor per lyerje te produkteve dytesore, pra per nje cilesi te dores te dyte. Ne parim, nuk ka mbetje te bojes, riperdoret dhe riciklohet ne sistemin e lyerjes. Shkarkime te tjera vleresohen edhe lenda djegese e kaldajes se furres per tharjen e bojes. Ky sistem funksionon me lende djegese Gas (GLN). Nga djegia e gazit natyror, permbajtja e tij Propan çlirohet gaz CO_2.

Zhurmat qe prodhohen ne kete aktivitet vijne kryesisht nga makinerite prerese te profileve metalike, si dhe makinerite zmeriluzuese. Proçesi i prodhimit shoqerohet me çlirim zhurme, por keto zhurma mbeten brenda ambjentit te punes, nuk vleresohet ne nivele te tilla sa qe te jene e shqetesuese per zonen, madje, ne ambjentet e jashtme te repartit, keto zhurma jane te pandjeshme. Punonjesit e ekspozuar ndaj burimeve te zhurmes, duhet qe te perdorin vazhdimisht kufje mbrojtese por edhe te mos punojne me orare te zgjatura, rekomandohet deri ne gjashte ore ne nje dite pune. Vibrime nga ky aktivitet nuk vleresohet te kete. Nuk ka mullinj, nuk ka rula te medhenj rrotullues, nuk ka punime me çekiçe pneumatike, etj. Proceset e punes nuk ndikojne ne toke per shkak te ambjenteve te pershtatshme e bashkekohore, te shtruara me beton dhe per shkak se nuk shkarkohen ujera te perdorura ne mjedisin e zones. Nisur nga fakti se nuk ka shkarkime ne toke, shkarkime te ujerave te perdorura, mbetje te ngurta per tu hedhur (mbetjet metalike dergohen te gjitha per riciklim, shiten), as shkarkime ne ajer te cilat te depozitohen ne tokat perreth, arrijme ne konkluzionin se aktiviteti nuk ndikon ne toke. Objekti eshte i ndertuar.

Kjo zonë nuk bënë pjesë në zonn te mbrojtur. Lloji i aktivitetit per vendodhjen qe ka nuk ndikon ne demtimin e biodiversitetit te zones. Nuk ka shkarkime te ujerave te perdorura, nuk ka shkarkime te mbetjeve te ngurta as te gazeve te demshme ne ajer, me perjashtim te

lendes djegese gazit GLN. Objekti ndodhet ne zone industriale dhe nuk prek biodiversitetin e zones. Ndikimi i ketij aktiviteti ne mjedisin social, eshte pozitiv persa i perkete punesimit, sherbimit te prodhimit e shitjes se ketyre produkteve.
Mbetjet qe prodhohen ne kete aktivitet jane: Copeza metali hekuri, llamarine, pluhur metali ferroz, nga aktiviteti human, mbetje urbane te tilla si: mbetje plastike, qelqi, qese dhe kartona nga ambalazhet, etj. Nuk vleresohet aktivitet me mbetje te ngurta, pasi materiali eshte 100% i perdorshem, si pluhuri metalit si copezat shiten per skrap, dergohen per riciklim ne kompanite e licensuara per kete qellim (Subjekti "Hiqmet Lelaj" P.F Vlore).
Klasifikimi i ketyre mbetjeve sipas Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve eshte si me poshte:
Mbetjet industriale nga aktiviteti

12 01 01	Tallash të metaleve ferrore (Mbetje jo te rrezikshme)
12 01 02	Pluhur dhe pjesë të imëta të metaleve ferrore (Mbetje jo te rrezikshme)

Mbetjet urbane nga aktiviteti human

20 01 01	Letër dhe karton
20 01 02	Qelq
20 01 39	Plastikët
20 01 40	Metalet

6. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE.

Ndikimi i aktivitetit ne kushte normale funksionimi zgjat per aq kohe sa zgjat edhe aktiviteti prodhues, pra rreth 8 ore ne dite. Ndikimi ne mjedis zgjat per aq ore sa funksionon aktiviteti ne dite dhe aq dite sa ai funksionon ne vit. Proçeset e prodhimit nuk ndikojne ne mjedisin e zones. Nuk kemi shkarkim te ujerave teknologjike pasi aktiviteti yne nuk perdor uje ne proceset e punes, ndersa ndersa shkarkimet ne ajer nga kaldaja, do te jene prezente gjate gjithe kohes qe do te jete ne funksion edhe reparti i prodhimit.

7. SHTRIRJA HAPËSINORE E NDIKIMIT NEGATIV NË MJEDISIN E ZONËS.

Ndikimi ne mjedisin e zones ne kushte normale te punes, perhapet vetem ne mjediset e magazines. Nuk ka shkarkime te ujerave teknologjike, ndikimi nga zhurmat do te jete prezent vetem ne mjediset e punes, ndersa shkarkimet ne ajer nga kaldja e gazit, perhapen ne atmosfere dhe kane nje ndikim me te gjere.

8. REHABILITIMI I MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSIA E KTHIMIT TË TIJ NË GJENDJEN E MËPARSHME.

Subjekti investitor, duhet te kujdeset per nje mjedis te paster, te rregullt, te gjelberuar, te sigurte dhe te pajisur me sinjalistiken dhe posterat sensibilizues perkates per kushtet teknike te punes dhe per mbrojtjen e mbajtjen paster te mjedisit. Ne rast te mbylljes se aktivitetit, mund te merret ne konsiderate mundesia e zhvillimit te aktiviteteve tregtare e industriale. Ambjentet perreth magazines jane te gjelberuara ne nje brez te gjelber ne te gjithe perimetrin e objektit. Pyllezime te tilla, subjekti duhet ti kryeje me qellim kompensimin e dioksidit te karbonit te çliruar ne atmosfere, te cilin biomet e thithin per te prodhuar oksigjen.

9. MASAT E MUNDSHME PËR SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS.

Ne menyre te pergjithshme paraqesim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga zhvilluesi i aktivitetit per mbarevajtjen e punes dhe ruajtjen e mjedisit.

- Ne sheshet perreth aktivitetit, nuk duhet te magazinohen materiale te rrezikshme, nuk duhet te magazinohen mbetje as produkte, ato te ruhen te gjitha brenda repartit.
- Subjekti te mos shfrytezoje burimet ujore apo ato tokesore te zones pa marre miratimin e autoriteteve perkatese.
- Te menaxhohen mbetjet e ngurta ne menyre te integruar dhe te zbatohen perkufizimet e Ligjit nr. 10463, date 22.09.2011, "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve".
- Te respektohen normat ne fuqi te shkarkimeve ne mjedis sipas VKM Nr. 177, date 31.03.2005 "Për normat e lejuara të shkarkimeve të lengëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse".
- Ne asnje menyre te mos shkarkohen ujera te perdorura ne kanalizimet e zones.
- Punonjesit te pajisen dhe te perdorin rregullisht masat mbrojtese ne pune si veshje, maska, syze, tapa per veshet, kufje, etj me qellim ruajtjen e shendetit te tyre.
- Te kryhet monitorim i rregullt i elementeve te mjedisit dhe te shkarkimeve ne ujera, ajer dhe zhurmat. Perfshi edhe kushtet e punes per punonjesit brenda repartit.
- Te mirembahen siperfaqet e gjelberta perreth objektit dhe mundesisht te mbillen te tjera me qellim rritjen e sistemit kapes te dioksidit te karbonit qe çlirohet nga kaldaja.

10. NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDISIN NDËRKUFITAR (NËSE PROJEKTI KA NATYRË TË TILLË).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhoje edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim te mjedisit nderkufitar. Projekti nuk ndikon ne cenimin e sigurise se jetes dhe shendetit te shteteve fqinje, madje me kushtet qe jane zbatuar gjate ndertimit, as te qendrave te banuara te rajonit. Nuk ndikohen burimet ujore nderkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit ne kontekstin nderkufitar.